



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2843/7 prot

Datë 15.12.2023

V E N D I M

Nr. 1316/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.12.2023 me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “Primus Albania” SHPK & “Nexia Al Consulting” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr.REF-83007-10-10-2023, me objekt: “*Upgrade i programit të faturimit, migrim i të dhënave, audit dhe web serviseve për pagesa*” me fond limit 1.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 23.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Qarku Shkodër.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Kreatx” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Autoriteti Kontraktor:

Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Qarku Shkoder me adresë: Lagjia 3 Heronjte, Rruga Marin Biçikemi, Shkoder

Ankimues:

BOE “Primus Albania” SHPK me NUIS L42202028V, me adresë: Rruga Margarita Tutulani, Pallati Viridario 1 Tiranë & “Nexia Al Consulting” SHPK, me NUIS L82210031Q, me adresë: Rruga Margarita Tutulani, Pallati Viridario 1, Kati 2, Tiranë.

Operatori ekonomik “Kreatx” SHPK me NUIS L12121023B, me adresë: Njësia Bashkiake nr. 5, Rruga Tish Daija, Kompleksi Kika 2, Godina 1, Shkalla 1, Zyra nr.2 ,Tiranë.

Subjekte të Interesuar:

Operatori ekonomik “Ei3 Software Solution” SHPK me NIPT L62221018T, me adresë: Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga Robert Shvarc, Nd.15, Nr.Pasurie 6/817-D, Tiranë

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

1.5. Operatorët ekonomikë ankimes kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 11.10.2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr.REF-83007-10-10-2023, me objekt: “*Upgrade i programit të faturimit, migrim i të dhënave, audit dhe web serviseve për pagesa*” me fond limit 1.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 23.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Qarku Shkodër.

II.2. Në datën 31.10.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit përfundimtar të ofertave, përkatësisht:

“Kreatx” SHPK	990,000 lekë, skualifikuar
“Primus Albania” SHPK & “Nexia AI Consulting“ SHPK	999,000 lekë, skualifikuar
“Ei3 Software Solution” SHPK,	1,200,000lekë, kualifikuar
“iCom” SHPK	1,300,000lekë, skualifikuar

II.4. Në datën 10.11.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE njoftimin e fituesit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

BOE “Primus Albania” SHPK & “Nexia AI Consulting“ SHPK rezulton i skualifikuar me argumentat e mëposhtme:

Referuar pikës 2.3.3 *Operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga autorët e programit kompjuterik "Al-Billing", sistemi i faturimit në përdorim dhe rregjistruar pranë ZSHDA me Nr. 57 RDA per kategorinë e veprës “Programe Kompjuterike”, Neni 7/A, ose ekuivalente. Gjithashtu mund të paraqesin Autorizim të lëshuar nga autorët e programit kompjuterik, që kanë të drejtën të ofrojnë shërbimin për "Programin kompjuterik AL Billing".*

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri Operatoret Ekonomikë duhet të paraqese autorizimin e shërbimit për "Programin kompjuterik AL Billing" ne nje afat kohor jo me te vjeter se 3 vite te shërbimit për "Programin kompjuterik AL Billing" referuar ligji nr.35/2016, "Per te drejtat e autorit dhe te drejtave te lidhura me to", neni 48 "Kontrata e se drejtes se autorit", pika 4 ku operatori ekonomik te kete autorizim aktiv te vlefshem me afat trevjeçar te referuar kesaj pike. Autorizimi i paraqitur mban daten 19.07.2016

Operatori ekonomik “Kreatx” SHPK rezulton i skualifikuar nga KVO-ja me argumentat e mëposhtme:

1. **Referuar pikës 2.3.3** *Operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga autorët e programit kompjuterik "Al-Billing", sistemi i faturimit në përdorim dhe rregjistruar pranë ZSHDA me Nr. 57 RDA per kategorinë e veprës “Programe Kompjuterike”, Neni 7/A, ose ekuivalente. Gjithashtu mund të paraqesin Autorizim të lëshuar nga autorët*

e programit kompjuterik, që kanë të drejtën të ofrojnë shërbimin për "Programin kompjuterik AL Billing".

2. *Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri Operatoret Ekonomikë duhet të paraqesë çertifikate të drejtes se autorit, autorizimin e shërbimit për "Programin kompjuterik AL Billing". Kjo shoqëri nuk ka paraqitur çertifikate regjistrimi dhe as autorizim nga autoret e këtij programi.*

II.5. Në datën 16.11.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2843/2023 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3612 e BOE "Primus Albania" SHPK & "Nexia AI Consulting" SHPK për procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur e thjeshtuar", me Nr.REF-83007-10-10-2023, me objekt: "Upgrade i programit të faturimit, migrim i të dhënave, audit dhe ëeb serviseve per pagesa" me fond limit 1.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 23.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Qarku Shkoder.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE "Primus Albania" SHPK & "Nexia AI Consulting" SHPK.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.2843/2 prot, datë 17.11.2023.

II.6. Në datën 16.11.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2857/2023 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3617 e operatorit ekonomik "Kreatx" SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "Kreatx" SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit. .

II.6.1. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.2857/2 prot, datë 17.11.2023.

II.7. Në datën 30.11.2023, nëpërmjet shkresës me nr. 2843/3 prot., me objekt: "Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së, lidhur me ankesën e BOE "Primus Albania" SHPK & "Nexia AI Consulting" SHPK dhe operatorit ekonomik "Kreatx" SHPK", me qëllim vijimin e gjykimit të ankesave të paraqitura pranë KPP-së, në përputhje me nenin 114 të LPP-së, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor të dërgojë pranë

këtij Komisioni, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkresë, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave; të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e BOE ankimes “Primus Albania” SHPK & “Nexia Al Consulting” SHPK dhe pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Kreatx” SHPK, si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesave të lartpërmendura.

II.8. Në datën 11.12.2023 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 2843/4 prot., shkresa e autoritetit kontraktor 2204/1 prot., datë 06.12.2023, me objekt: “*Informacion në lidhje me shkresën nr. 2843/3 prot., datë 30.11.2023*”, me anë të së cilës autoriteti kontraktor bën me dije Komisionin e Prokurimit Publik, se ankesat nuk janë shqyrtuar për arsye të mungesës së personelit të specializuar.

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të BOE “Primus Albania” SHPK & “Nexia Al Consulting” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.3. e dokumenteve të tenderit të publikuara në SPE, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga autorët e programit kompjuterik "Al-Billing", sistemi i faturimit në përdorim dhe rregjistruar pranë ZSHDA me Nr. 57 RDA per kategorinë e veprës "Programe Kompjuterike", Neni 7/A, ose ekuivalente. **Gjithashtu mund të paraqesin Autorizim të lëshuar nga autorët e programit kompjuterik, që kanë të drejtën të ofrojnë shërbimin për "Programin kompjuterik AL Billing".**

III.1.2. Në përmbushje të kriterit të sipërcituar, BOE “Primus Albania” SHPK & “Nexia Al Consulting” SHPK ka paraqitur dokumentacionin si vijon:

1. Certifikatë Regjistrimi të Drejtë Autori, për z.K.Z, në emër edhe të bashkëautorit tjetër Z. I.SH, lëshuar nga Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për veprën “Programe Kompjuterike “Al-Billing””, nr. 57 RDA, neni 7/A, për kategorinë e veprës “Programe kompjuterike”, më datë 27.12.2011.

2. Autorizim me datë 19.07.2016, me palë z. K.Z [...] në cilësinë e bashkëautorit të veprës Programi Kompjuterik “Al Billing” dhe z. I.SH në cilësinë e bashkëautorit të veprës Programi Kompjuterik “Al Billing” me anë të së cilës [...] *autorizohet shoqëria “Jehona Software” SHPK të ofrojë shërbimin e kërkuar për programin kompjuterik “Al Billing” në të gjithë procedurat e prokurimit apo projektet në të cilat është pjesëmarrëse. Shoqërisë “Jehona Software” SHPK i kalohen të drejtat e përfaqësimit për të gjitha projektet si dhe për periudhën kohore në të cilën ai do të zgjasë. Me anë të këtij autorizimi bashkëautorët e lartpërmendur bien dakort të caktojnë shoqërinë “Jehona Software” SHPK si titullare të këtyre të drejtave nga momenti i nënshkrimit të saj.*
3. Certifikatë Regjistrimi të Drejtë Autori, për z.K.Z, lëshuar nga Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit, Ministria e Kulturës për veprën me titull “J-Billing” nr. 156 RDA për kategorinë e veprave “Programe Kompjuterike”, neni 7/b.
4. Kontratë për Njohjen e të Drejtave Ekonomike të Programit “J-Billing”, e lidhur në datën 29.08.2022 ndërmjet palëve “Primus Albania” SHPK, ish “Jehona Software” SHPK, quajtur punëdhënësi dhe z. K.Z, ekspert i teknologjisë së informacionit, i quajtur punëmarrës, për njohjen e të drejtave ekonomike që ka punëdhënësi mbi programin kompjuterik “J-Billing”, me kushtet si më poshtë:[...]. Në nenin 2 “Objekti”, të kontratës, është parashikuar: *“Punëdhënësi, një shoqëri që kryen aktivitetin në fushën e teknologjisë të informacionit, ika kërkuar Punëmarrësit të punësuar pranë Punëdhënësit në Janar 2015 të realizojë një program kompjuterik që do të përdorej kryesisht nga ujësjellës- kanalizimet në mbarë vendin për faturimin e abonentëve të tyre, etj. Punëmarrësi, duke zotëruar certifikimin dhe ekspertizën e duhur në ushtrim të funksioneve profesionale e funksionale të tij dhe me kërkesë të Punëdhënësit mori përsipër dhe realizoi programin kompjuterik të kërkuar nga Punëdhënësi. Programi kompjuterik i hartuar sipas kërkesave teknike të Punëdhënësit u emërua “J-Billing” dhe në zbatim të ligjit, u regjistrua nga Punëmarrësi në Zyrën Shqiptare për të Drejtat e Autorit me titullin “J-Billing” me nr.156 RDA, , datë 07.05.2015 në Kategorinë e Veprave “Programe Kompjuterike”, neni 7/b. Bazuar në nenin 35/2016, “Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të”, neni 89 “Programi kompjuterik i krijuar në kushtet e punësimit”, meqë Punëmarrësi e krijoi programin kompjuterik “J-Billing” në ekzekutim të detyrave profesionale e funksionale dhe sipas udhëzimeve të dhëna nga Punëdhënësi i tij, ky i fundit ekskluzivisht ka të drejtë të ushtrojë të gjitha të drejtat ekonomike për programin “J-Billing. Pra, Punëmarrësi në kuptim të ligjit 35/2016 “Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të”, njeh dhe i kalon Punëdhënësit të drejtat ekonomike të Programit Kompjuterik “J-Billing” dhe Punëdhënësi, si titullar i të drejtave ekskluzive të programit kompjuterik “J-Billing”, ka të drejtën e shfrytëzimit të programit kompjuterik brenda territorit të Republikës së Shqipërisë në një afat kohor të pakufizuar”. [...].*

III.1.3. Në ankesën e paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik BOE “Primus Albania” SHPK & “Nexia Al Consulting” SHPK kundërshton argumentet e KVO-së, duke pretenduar si vijon:

“Në DST, në shtojcën 8 Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kulaiifikimit, 2.3.3 Kapaciteti teknik, ju keni kërkuar:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga autorët e programit kompjuterik "Al-Billing", sistemi i faturimit në përdorim dhe regjistruar pranë ZSHDA me Nr. 57 RDA per kategorinë e veprës “Programe Kompjuterike”, Neni 7/A, ose ekuivalente. **Gjithashtu mund të paraqesin Autorizim të lëshuar nga autorët e programit kompjuterik, që kanë të drejtën të ofrojnë shërbimin për "Programin kompjuterik AL Billing".**

Për të plotësuar këtë kriter Primus Albania SHPK, në emër të BOE, ka ngarkuar në SPE të APPautorizimin e autorëve të programit kompjuterik të faturimit Al-Billing dhe certifikatën e regjistrimit të programit kompjuterik të faturimit J-Billing që është version i përmirësuar i programit kompjuterik të faturimit Al-Billing. Paraqitja e certifikatës të regjistrimit të programit kompjuterik të faturimit J-Billing u bë bazuar në kriterin tuaj të mësipërm dhe konkretisht në togfjalëshin “... ose ekuivalen”. Lidhur me pretendimin e KVO-së se: “... OE ka autorizim më të vjetër se tre vjet ...”, duke ju referuar autorizimit të autorëve të programit kompjuterik të faturimit Al-Billing, ju sqarojmë:

- a) Në formulimin tuaj të arsyeve të refuzimit të ofertës të krijohet përshtypja që ky kusht, pra “...OE ka autorizim më të vjetër se tre vjet ...” është pjesë e kriterit në fjalë 2.3.3, ndërkohë që referuar DST ky kusht nuk është pjesë e këtij kriteri pasi sipas vendimit të KPP nr. 475/2023 ai u hoq.
- b) Autorizimi në kuptim të ligjit nr. 9380, dt.28.04.2005 (të cilit i referohet), por edhe të ligjit nr. 35/2016 “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejta e Tjera të Lidhura me to”, i kalon shoqërisë Jehona Software SHPK, sot Primus Albania SHPK të drejtat e përfaqësimit për të gjitha projektet si dhe për periudhën kohore në të cilën ai do të zgjasë dhe e cakton Jehona Software SHPK si titullare të të drejtave të autorit. Pra, referuar autorizimit dhe në kuptim të ligjit nr. 35/2016, Jehona Software SHPK sot Primus Albania SHPK është caktuar Titullare e të Drejtave të Autorit.
- c) Ligji nr.35/2026, neni 46,pika 1 dhe 2 shprehen si më poshtë:
 1. Të drejtat pasurore të autorit ose titullari i të drejtave të autorit mund të kalojnë me kontratë në formën ekskluzive ose joekskluzive. Si rezultat i këtij kalimi, pala së cilës i kalohen këto të drejta është mbajtësi i ri i së drejtës së autorit, në përputhje me kushtet e kontratës.
 2. Në rastin e kalimit të së drejtës në formën ekskluzive, autori/pronari i veprës origjinale nuk e ushtron më të drejtën e përdorimit të veprës gjatë periudhës kohore dhe për territorin për të cilin është rënë dakord, si dhe nuk ka të drejtë t’ia kalojë të njëjtin tagër një pale të tretë. Në këtë rast, në bazë të kontratës ekskluzive, mbajtësi i së drejtës ekskluzive mund të shfrytëzojë një vepër autori duke përjashtuar çdo person tjetër, përfshirë autorin, nga një përdorim i tillë, përveçse kur është parashikuar ndryshe në këtë ligj. Brenda këtyre kufijve, ai gjithashtu gëzon të drejtën të autorizojë ose të ndalojë të tretët për përdorimin e veprës dhe vetëm nëse këto të drejta parashikohen shprehimisht në kontratë. Forma ekskluzive e kalimit të të drejtave duhet të përcaktohet shprehimisht në kontratën mes palëve. Kontrata është e vlefshme kur bëhet sipas dispozitave të këtij ligji dhe të legjislacionit civil në fuqi.

Autorizimi në vetvete i referohet Kodit Civil të RSH dhe konkretisht nenit 659 e në vijim që trajton kontratat. Pra me kalimin e të drejtës në formë ekskluzive (sic është rasti i Jehona

Software SHPK) autori i veprës nuk e ushtron më të drejtën e përdorimit të veprës gjatë periudhës kohore dhe për territorin për të cilin është rënë dakort si dhe nuk ka të drejtë t'ia kalojë të njëjtin tagër një pale të tretë. Për më tej, si Titullare e të Drejtave të Autorit, Jehona Software SHPK sot Primus Albania SHPK gjithashtu gëzon të drejtën të autorizojë ose të ndalojë të tretët për përdorimin e veprës.

d) Ligji nr. 35/2016, neni 48, pika 4 shprehet si më poshtë:

4. Nëse kontrata e së drejtës së autorit nuk parashikon afatin e saj të vlefshmërisë, konsiderohet se është lidhur për një afat trevjeçar që nga data e lidhjes së saj, nëse ka të bëjë me përdorimin e veprës në formën e saj origjinale, si dhe, për pesë vjet, në rast se ka të bëjë me përdorimin e veprës në një formë të përshtatur apo të ndryshuar në mënyrë tjetër ose të përkthyer.

Neni në fjalë shprehet qartë “Nëse kontrata e së drejtës së autorit nuk parashikon afatin e saj të vlefshmërisë, konsiderohet se është lidhur për një afat trevjeçar që nga data e lidhjes së saj ...”. Në rastin konkret, autorizimi ka një afat kohor të cituar qartë në tekst “për periudhën kohore në të cilën ai do të zgjasë”. Pra, me anë të këtij togfjalëshi nga autorët e programit është përcaktuar qartë periudha kohore e vlefshmërisë së autorizimit, periudhë e cila lidhet me anën funksionale të programit kompjuterik të faturimit Al-Billing. Ky afat mund të ishte edhe më pak se tre vjet nëse programi kompjuterik nuk do të ishte funksional apo nuk do të kërkohej nga tregu. Pra, pretendimi juaj se: ‘...OE ka autorizimin më të vjetër se tre vjet ...’, në rastin konkret nuk ka asnjë bazë ligjore dhe nuk qëndron.

Referuar argumentetë mësipërme, BOE Primus Albania SHPK dhe Nexia Al Consulting SHPK e plotëson kriterin 2.3.3 të vendosur nga Autoriteti Kontraktor.”

III.1.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.5. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, pika 1 dhe 4, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

III.1.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.7. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se BOE “Primus Albania” SHPK & “Nexia AI Consulting” SHPK ka paraqitur dokumentin “Certifikatë Regjistrimi të Drejtë Autori”, për z. K.Z, në emër edhe të bashkëautorit tjetër z. I.SH, lëshuar nga Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për veprën “Programe Kompjuterike “AI-Billing””, nr. 57 RDA, neni 7/A, për kategorinë e veprës “Programe kompjuterike”, me datë 27.12.2011. Kjo certifikatë është shoqëruar me Autorizim me datë 19.07.2016, me palë z. K.Z [...] në cilësinë e bashkëautorit të veprës Programi Kompjuterik “AI Billing” dhe z. I.SH në cilësinë e bashkëautorit të veprës Programi Kompjuterik “AI Billing” me anë të së cilës [...] *autorizohet shoqëria “Jehona Software” SHPK të ofrojë shërbimin e kërkuar për programin kompjuterik “AI Billing” në të gjithë procedurat e prokurimit apo projektet në të cilat është pjesëmarrëse. Shoqërisë “Jehona Software” SHPK i kalohen të drejtat e përfaqësimit për të gjitha projektet si dhe për periudhën kohore në të cilën ai do të zgjasë. Me anë të këtij autorizimi bashkëautorët e lartpërmendur bien dakort të caktojnë shoqërinë “Jehona Software” SHPK (sot Primus Albania SHPK) si titullare të këtyre të drejtave nga momenti i nënshkrimit të saj. Rezulton, se përveç programit kompjuterik "AI-Billing", BOE Primus Albania” SHPK & “Nexia AI Consulting” SHPK ka paraqitur në ofertë “Certifikatë Regjistrimi të Drejtë Autori”, për z. K.Z, lëshuar nga Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit, Ministria e Kulturës për veprën me titull “J-Billing” nr. 156 RDA për kategorinë e veprave “Programe Kompjuterike”, neni 7/b, shoqëruar me Kontratën për Njohjen e të Drejtave Ekonomike të Programit “J-Billing”, e*

lidhur në datën 29.08.2022 ndërmjet palëve “Primus Albania” SHPK, ish “Jehona Software” SHPK, quajtur punëdhënësi dhe z. K.Z, ekspert i teknologjisë së informacionit, i quajtur punëmarrës, për njohjen e të drejtave ekonomike që ka punëdhënësi mbi programin kompjuterik “J-Billing”, me kushtet si më poshtë: [...]. Në nenin 2 “Objekti”, të kontratës, është parashikuar: *“Punëdhënësi, një shoqëri që kryen aktivitetin në fushën e teknologjisë të informacionit, ika kërkuar Punëmarrësit të punësuar pranë Punëdhënësit në Janar 2015 të realizojë një program kompjuterik që do të përdorej kryesisht nga ujësjellës-kanalizimet në mbarë vendin për faturimin e abonentëve të tyre, etj. Punëmarrësi, duke zotëruar certifikimin dhe ekspertizën e duhur në ushtrim të funksioneve profesionale e funksionale të tij dhe me kërkesë të Punëdhënësit mori përsipër dhe realizoi programin kompjuterik të kërkuar nga Punëdhënësi. Programi kompjuterik i hartuar sipas kërkesave teknike të Punëdhënësit u emërua “J-Billing” dhe në zbatim të ligjit, u regjistrua nga Punëmarrësi në Zyrën Shqiptare për të Drejtat e Autorit me titullin “J-Billing” me nr.156 RDA, , datë 07.05.2015 në Kategorinë e Veprave “Programe Kompjuterike”, neni 7/b. Bazuar në nenin 35/2016, “Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të”, neni 89 “Programi kompjuterik i krijuar në kushtet e punësimit”, meqë Punëmarrësi e krijoi programin kompjuterik “J-Billing” në ekzekutim të detyrave profesionale e funksionale dhe sipas udhëzimeve të dhëna nga Punëdhënësi i tij, ky i fundit ekskluzivisht ka të drejtë të ushtrojë të gjitha të drejtat ekonomike për programin “J-Billing. Pra, Punëmarrësi në kuptim të ligjit 35/2016 “Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të”, njeh dhe i kalon Punëdhënësit të drejtat ekonomike të Programit Kompjuterik “J-Billing” dhe Punëdhënësi, si titullar i të drejtave ekskluzive të programit kompjuterik “J-Billing”, ka të drejtën e shfrytëzimit të programit kompjuterik brenda territorit të Republikës së Shqipërisë në një afat kohor të pakufizuar”. [...]. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se në dokumentet e tenderit objekt - ankimimi, të publikuara në SPE në datën 11.10.2023, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga autorët e programit kompjuterik “Al-Billing”, sistemi i faturimit në përdorim dhe rregjistruar pranë ZSHDA me Nr. 57 RDA per kategorinë e veprës “Programe Kompjuterike”, Neni 7/A, ose ekuivalente, pra është lejuar që operatorët ekonomikë mund të paraqesin edhe dokumentacion ekuivalent me atë të kërkuar si në pikën 2.3.3. të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit si më sipër cituar. Në përmbushje të kësaj kërkesë BOE “Primus Albania” SHPK & “Nexia AI Consulting” SHPK ka vërtetuar me dokumentacion përkatës si më sipër cituar, se plotëson kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, si për Programin Kompjuterik “Al-Billing”, ashtu edhe për atë “J-Billing”. Për më tepër konstatohet, se AK nuk ka dhënë asnjë argument lidhur programin kompjuterik “J-Billing”, megjithëse nga ana e tij është lejuar paraqitja e programeve kompjuterike ekuivalent me atë Al-Billing.*

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se përfituesi i drejtpërdrejtë i shërbimit të kërkuar është vetë autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas legjislacionit në fuqi, kjo bazuar në nenin 124 të LPP-së ku përcaktohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të ndjekë zbatimin e kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi. 2. Për monitorimin e zbatimit të kontratës, autoriteti ose enti kontraktor, nisur nga natyra e objektit të kontratës dhe*

kohëzgjatja e zbatimit të saj, harton planin e zbatimit të kontratës, duke përfshirë në veçanti çështjet organizative, afatet, çështjet ekonomike e teknike të kontratës së nënshkruar, në përputhje me çdo akt tjetër ligjor. 3. Plani i zbatimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga autoriteti ose enti kontraktor dhe operatori ekonomik brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj. 4. Çdo modifikim i kontratës në përputhje me nenin 127 të këtij ligji, pasqyrohet në planin e zbatimit. 5. Autoriteti ose enti kontraktor, në përputhje me planin, ndjek zbatimin e kontratës, administron dokumentacionin e monitorimit dhe harton raportet e monitorimit. 6. Rregulla të hollësishme për monitorimin e zbatimit të kontratave, sipas tipologjive të tyre, përcaktohen nga rregullat e prokurimit publik. Autoriteti kontraktor duhet të kryejë pagesat në favor të operatorëve ekonomikë, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të fushës në fuqi.”

Pra është autoriteti kontraktor si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, pikërisht ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit të kërkuar është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Për sa më sipër, pretendimet e BOE “Primus Albania” SHPK & “Nexia AI Consulting” SHPK qëndrojnë.

III.2. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK, se: **“Referuar pikës 2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga autorët e programit kompjuterik “Al-Billing”, sistemi i faturimit në përdorim dhe rregjistruar pranë ZSHDA me Nr. 57 RDA per kategorinë e veprës “Programe Kompjuterike”, Neni 7/A, ose ekuivalente. Gjithashtu mund të paraqesin Autorizim të lëshuar nga autorët e programit kompjuterik, që kanë të drejtën të ofrojnë shërbimin për “Programin kompjuterik AL Billing”. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri Operatore Ekonomikë duhet të paraqese certifikate te drejtes se autorit, autorizimin e shërbimit për “Programin kompjuterik AL Billing”. Kjo shoqeri nuk ka paraqitur cerifikate regjistrimi dhe as autorizim nga autoret e ketij programi.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:**

III.2.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.3. e dokumenteve të tenderit të publikuara në SPE, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga autorët e programit kompjuterik “Al-Billing”, sistemi i faturimit në përdorim dhe rregjistruar pranë ZSHDA me Nr. 57 RDA per kategorinë e veprës “Programe Kompjuterike”, Neni 7/A, ose ekuivalente. Gjithashtu mund të paraqesin Autorizim të lëshuar nga autorët e programit kompjuterik, që kanë të drejtën të ofrojnë shërbimin për “Programin kompjuterik AL Billing”.

III.2.2. Në përmbushje të kriterit të sipërcituar, operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacionin si vijon:

1. Deklaratë e titullarit të së drejtës së shfrytëzimit, me anë të së cilës subjekti “Kreatx” SHPK ka deklaruar se është: **“Titullar i të Drejtës së Shfrytëzimit të Programit Kompjuterik FLARE Billing. Në dokumentacionin e dorëzuar gjendet Certifikata e Rregjistrimit e Drejtë e Autorit për Flare Billing Nr. 203-2, dt 10/12/2013”.**

2. Certifikatë Regjistrimi të Drejtë Autori, lëshuar nga Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit, Ministria e Kulturës me datë 10.12.2013 me anë të së cilës është vendosur regjistrimi dhe certifikimi me titullin e të drejtës së shfrytëzimit ekonomik subjekti “Kreatx” SHPK, për programin kompjuterik me titull “Flare Billing” nr. 203-2 RDA për kategorinë e veprave “Programe Kompjuterike”, neni 7/a.

III.2.3. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.2.4. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, pika 1 dhe 4, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”*

III.2.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në

dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.2.6. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Kreatx” SHPK ka paraqitur deklaratën e titullarit të së drejtës së shfrytëzimit, me anë të së cilës subjekti “Kreatx” SHPK deklaron, se është Titullar i të Drejtës së Shfrytëzimit të Programit Kompjuterik FLARE Billing si dhe dokumentin Certifikatë Regjistrimi të Drejtë Autori, lëshuar nga Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit, Ministria e Kulturës më datë 10.12.2013, me anë të së cilës është vendosur regjistrimi dhe certifikimi me titullin e së drejtës së shfrytëzimit ekonomik subjekti “Kreatx” SHPK, për programin kompjuterik me titull “Flare Billing” nr. 203-2 RDA për kategorinë e veprave “Programe Kompjuterike”, neni 7/a.

Lidhur me pretendimin e autoritetit kontraktor se operatori ekonomik ankimues nuk ka paraqitur certifikatë regjistrimi dhe as autorizim nga autorët e këtij programi (duke iu referuar programit kompjuterik “AL-Billing), Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se në dokumentet e tenderit objekt - ankimimi, të publikuara në SPE në datën 12.10.2023, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar shprehimisht që *operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga autorët e programit kompjuterik "Al-Billing", sistemi i faturimit në përdorim dhe rregjistruar pranë ZSHDA me Nr. 57 RDA per kategorinë e veprës "Programe Kompjuterike", Neni 7/A, ose ekuivalente*, pra është lejuar që operatorët ekonomikë mund të paraqesin edhe dokumentacion ekuivalent me atë të kërkuar si në pikën 2.3.3. të kapacitetit teknik të dokumentave të tenderit si më sipër cituar, kërkesë e cila është plotësuar nga shoqëria “Kreatx” SHPK nëpërmjet Programit Kompjuterik “Flare Billing”. Autoriteti kontraktor nuk ka dhënë asnjë argument lidhur me këtë fakt, pra pse programi i paraqitur nga ankimuesi nuk është ekuivalent me atë të kërkuar nga AK dhe nuk plotëson nevojat për objektin e prokurimit. Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron, se përfituesi i drejtpërdrejtë i shërbimit të kërkuar është vetë autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas legjislacionit në fuqi. Pra është autoriteti kontraktor si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, pikërisht ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit të kërkuar është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë

ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e BOE “Primus Albania” SHPK & “Nexia AI Consulting” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-83007-10-10-2023, me objekt: “Upgrade i programit të faturimit, migrim i të dhenave, audit dhe web serviseve për pagesa” me fond limit 1.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 23.10.2023, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Qarku Shkodër.
2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të shfuqizojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e BOE “Primus Albania” SHPK & “Nexia AI Consulting” SHPK dhe operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK, duke i kualifikuar ata.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Primus Albania” SHPK & “Nexia AI Consulting” SHPK.
6. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Kreatx” SHPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

